



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

Datë: 13.10.2025
Numër Protokolli: 6793/2025

A.nr.1676/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari -anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1676/2025, të datës 09.09.2025, të parashtruar nga ankuesi B.T kundër Vendimit Nr.05/265 të datës 01.08.2025 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1676/2025, e datës 09.09.2025, e parashtruar nga ankuesi B.T.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim, B.T (*tani e tutje referuar si ankuesi*), më datë 09.09.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.05/265 të datës 01.08.2025 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me procedurën e pranimit sipas konkursit me numër reference RN00017202 për pozitën e nivelit të lartë drejtues, “*Drejtor Ekzekutiv*” në Agjencinë e Kosovës për Forenzik.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se vendimi me numër 05/265 i datës 01.08.2025 i Qeverisë së Republikës së Kosovës është përcill me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike si dhe shkelje të dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 16.09.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit më datë, 02.10.2025 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) në këtë çështje administrative administroi këto **prova**: Ankesën me numër protokolli 6034/2025 të datës 09.09.2025/2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.05/265 të datës 01.08.2025 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr.0380/2025 të datës 02.07.2025; Vendimin me numër protokolli 01/59 të datës 11.08.2025; Emalin e datës 06.08.2025; Njoftimin me numër protokolli 1077 të datës 09.06.2025 për renditjen përfundimtare të kandidateve; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.09.2025; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1676/2025 të datës 02.10.2025; Konkursin e datës 19.03.2025 për pozitën e punës “*Drejtor Ekzekutiv*”; Njoftimin për renditjen përfundimtare me numër protokolli 1077 të datës 09.06.2025;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankuesit, **është e palejuar**, sepse:

Nga administrimi i provave materiale të ofruara nga palët në këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit konstatoi se Ministria e Punëve të Brendshme më datë 19.03.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00017202, për pozitën e nivelit të lartë drejtues, “*Drejtor Ekzekutiv*” në Agjencinë e Kosovës për Forenzike. Tutje sipas shkresave të lëndës, konstatohet fakti se Divizioni për Zhvillim e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik të Ministrisë së Punëve Brendshme, me datë 09.06.2025 ka publikuar Njoftimin për kandidatët e suksesshëm, sipas të cilit rezultoi se ka pasur gjashtë (6) kandidatë të suksesshëm, si në vijim: kandidati SH.D me gjithsejtë 86.6 pikë, kandidati I.K me gjithsejtë 81.8 pikë, kandidati M.T me gjithsejtë 80.2 pikë, kandidati B.T ankuesi me gjithsejtë 78.2 pikë kandidati F.H me gjithsejtë 78 pikë, dhe kandidatit S.D me gjithsejtë 70.6.

Kolegji i Këshillit, fillimisht thekson faktin se lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit, me datë 14.07.2025 kishte pranuar emalin nga Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, se lidhur me pozitën për “*Drejtorit Ekzekutiv*” a ka pasur ankesë të pranuar, ndërsa përmes emailit të datës 14.07.2025 Këshilli është përgjigjur se lidhur me pozitën e lartcekur nuk ka ndonjë ankesë të parashtruar në Këshill.

Pas pranimit të ankesës së ankuesit B.T të datës 09.09.2025, Kolegji i Këshillit i është drejtuar Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës me kërkesën për prova materiale në këtë çështje administrative, dhe nga shkresa e pranuar me datë 16.09.2025 nga kjo e fundit, Kolegji i Këshillit konstatoi se Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e datës 01.08.2025 merr vendimin me Nr.05/265 me të cilin z. SH.D emërohet në pozitën e “*Drejtorit Ekzekutiv*” në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë me mandat katër (4) vjeçar.

Kolegji i Këshillit më qëllim të konstatimit të pranueshmërisë së ankesës së ankuesit të datës 09.09.2025 fillimisht analizoi dhe mori bazë dispozitat e aplikuara të ligjit në fuqi nga koha e shpalljes së konkursit e deri të Njoftimi i datës 09.06.2025 për shpallen e kandidatëve të suksesshëm, gjegjësisht dispozitat e Ligjit Nr. . 08/L-197 Zyrtarët Publik nenin 47 paragrafi 7,8,9 dhe 10 i cili përcakton se; . *Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrenteve/ëve si dhe intervistë me gojë. 8. Të gjithë kandidatët/ët e vlerësuar nga komisioni i pranimit mbi pragun minimal të shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidate/at fitues dhe propozohen për përzgjedhjen përfundimtare nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë. Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. 9. Lista e kandidateve/ëve fitues i dërgohet mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë dhe bëhet publike nga njësia*

përgjegjëse në SIMBNj-së dhe me mjete të tjera të përshtatshme informimi, 10. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative. Kolegji i Këshillit duke u bazuar në ankesën e ankuesit të datës 09.09.2025 të parashtruar në Këshill përmes të cilit është kundërshtuar vendimin me numër 05/265 të datës 01.08.2025 i Qeverisë së Republikës së Kosovës e jo listën lidhur me njoftimin përfundimtar të rezultateve të konkursit për pozitën e punës “Drejtor Ekzekutiv” në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë konstaton se ankesa e ankuesit është e jashtë afatshme.

Andaj, Kolegji i Këshillit, nga përcaktimet e dhëna si më lartë të ligjit material, mori për bazë dispozitat e nenit 129 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji” dhe konstatoi se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 09.09.2025 është e papranueshme, pasi që ligji material të drejtën e ankimit ua ka njohur palëve në procedurë vetëm kundër aktit-njoftimit për shpalljen e rezultateve të kandidatëve të suksesshëm, ndërsa në rrethanat e rastit konkret ankuesi ka parashtruar ankesë kundër aktit për emërimin e njërit nga kandidatët e suksesshëm në procedurë, gjegjësisht në rrethanat e rasteve të tilla ankesat janë të palejuara pasi që me ligjin material nuk është përcaktuar ankesë kundër aktit për emërimin e kandidatit por vetëm kundër aktit, respektivisht njoftimit për kandidatët e suksesshëm.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nenit 129 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila mendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1676/2025,

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit B.T;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, *si dhe*
- Arkivit të KPMSHCK-së.